



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI

VENDIM

Nr. 58, datë 26.03.2021

PËR  
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT  
“INSIG JETË” SH.A., SI REZULTAT I ZMADHIMIT TË KAPITALIT THEMELTAR

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 57, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risgurimit”, si dhe Rregullores nr. 138, datë 21.12.2015 “Për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

**1. Ndryshimin e nenit 7, të statutit të shoqërisë së sigurimit “Insig Jetë” sh.a., si rezultat i rritjes së kapitalit, si më poshtë vijon:**

*“Neni 7 Kapitali i shoqërisë*

*Kapitali themeltar i shoqërisë bëhet 590,000,000 (pesëqind e nëntëdhjetë milion) lekë. Ai është i ndarë në 616,000 (gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) aksione të themeluesve të shoqërisë, të cilat janë të së njëjtës kategori me vlerë nominale 957,79 (nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë shtatëdhjetë e nëntë) lekë, për çdo aksion.*

*Aksionet janë të numëruara nga 1 deri në 616,000 përfshirë numrin e fundit të aksionit.*

*Pjesëmarrja e Eurosig sha në kapitalin themeltar të shoqërisë Insig Jetë sha është si më poshtë:*

| Nr. | Emërtimi           | Përqindja | Numri i aksioneve | Vlera në lekë |
|-----|--------------------|-----------|-------------------|---------------|
| 1.  | Eurosig sha-Tiranë | 100 %     | 616,000           | 590,000,000   |

*Aksionarët kanë të drejtën e fitimit (dividendit) mbi bazën e përqindjes së aksioneve që ata zotërojnë në shoqëri.*

*Shoqëria është krijuar dhe funksionon me motiv fitimin, megjithatë në rastet e humbjes, ajo mbulohet gjithashtu proporcionalisht me kontributin themeltar në aksione.”*

**2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**

**Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin METE**